



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Prill 2021

Nr. 267

**VENDIM**

**Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Partisë Demokratike për shkelje të parashikuara në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi

**Kërkues:** Partia Demokratike

**Ndaj:** Kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi

**Baza Ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

**VËREN:**

**I.Vlerësimi Paraprak**

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në portalin e denoncimeve nga Partia Demokratike, është raportuar denoncimi me nr. ID të gjeneruar nga sistemi 2721, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi me pretendimin se, në qarkun e Gjirokastrës, ka vendosur postera në fasadën e pallatit, i cili përdoret jo vetëm për banim por në të cilin ndodhen edhe zyrat e Postës Shqiptare Dega Tepelenë, në



kundërshtim me nenin 3 pika 2 të udhëzimit nr. nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Bashkëlidhur denoncimit, denoncuesi ka vënë në dispozicion edhe një foto të pallatit në të cilin z. Çuçi ka vendosur posterin e tij.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia nje shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

## II. Rrethanat e faktit

Në datën 23.03.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka miratuar udhëzimin nr. 6 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Në datën 01.04.2021 në portalin e denoncimeve të KQZ-së, është raportuar denoncimi i Partisë Demokratike ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi, për shkelje të udhëzimit nr. 6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke vendosur në një pallat banimi i cili njëkohësisht shërben edhe si seli e postës Shqiptare, dega Tepelenë, materiale propagandistike, në kundërshtim të plotë me çfarë ky udhëzim parashikon.

Administrata e KQZ-së, përmes personit të autorizuar prej saj, ka verifikuar kallëzimin e bërë nga Partia Demokratike ku gjatë raportit të ndërmjetëm të monitorimit, për Qarkun Gjirokastrë, rezulton se materialet propagandistike të vendosura në fasadën e pallatit që ndodhet pranë zyrës së filialit të Postës Shqiptare, nga subjekti Partia Socialiste, tashmë janë hequr.



## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

## **V E N D O S:**

- 1.Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi.
- 2.Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
- 4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 21 Prill 2021  
Nr. 267

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Partisë Demokratike për shkelje të parashikuara në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi